



**Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM) po vazhdon me implementimin e projektit për Stabilizimin e Komuniteteve IV (EU-CSP IV), projekt i cili financohet nga BE dhe menaxhohet nga Zyra e BE-së në Kosovë. Programi EU-CSP IV do të ofroj asistencë financiare dhe teknike për fillim të bizneseve të vogla apo zgjerim të atyre ekzistuese sidomos të atyre bizneseve që promovojnë dhe forcojnë reintegrimin e qëndrueshëm të anëtarëve të kthyer të komuniteteve jo-shumicë. Projekti EU-CSP IV poashtu do të përkrah edhe iniciativat e komunitetit prej të cilave komuniteti do të ketë përfitim më të gjërë duke punuar me pjesëtarët e komunitetit dhe fermerëve individual dhe prodhuesëve për të eksploruar mundësitë për aktivitete të përbashkëta përmes krijimit dhe mbështetjes së asociacioneve të biznesit të komuniteteve jo shumicë dhe ato ndërnike.**

**Projekti i Bashkimit Evropian për Stabilizimin e Komuniteteve (EU-CSP IV), SHPALL THIRRJEN PËR PROJEKT PROPOZIME të ndërmarrësve të ardhshëm dhe ekzistues si dhe të grupeve e asociacioneve PËR PROJEKTE INDIVIDUALE DHE TË KOMUNITETIT. EU-CSP IV do të financojë bizneset që mund të dëshmojnë realizueshmëri dhe qëndrueshmëri ekonomike dhe që ofrojnë mundësi punësimi e krijim të të ardhurave.**

**Për udhëzime dhe fletë-aplikacione aplikantët e interesuar inkurajohen për të vizituar uebfaqen e IOM-it [www.kosovo.iom.int](http://www.kosovo.iom.int) si dhe zyrat perkatese sipas orarit javor per komuna (tel: 049 968 485), ku poashtu mund të merrni më shumë informata të hollësishme për procesin e aplikimit dhe zhvillim të biznes planeve, formularë për aplikim si dhe ndihmë se si duhet të bëhet plotësimi i formularëve si dhe informata tjera për procesin dhe udhëzimet e aplikimit.**

**Afati i fundit për dorëzim të aplikacioneve është **31 Mars 2020** por aplikantët inkurajohen që t'i dorëzojnë aplikacionet e tyre sa më parë.**

Implemented by:



International Organization for Migration (IOM)  
The UN Migration Agency